



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tretë të Kuvendit, mbajtur më 10.06.2020, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Adrian Berisha (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Valbona Petrovci (e pavarur), Visare Gashi (PSD), Leonora Shabani – Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Arbër Vokri (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna – Hasani (LDK), Naime Osmani (LDK), Elmire Nikçi – Rexha (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Suzan Kika, (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (e pavarur), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Sami Boroci, (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Rifat Deri (i pavarur), Sokol Berisha (i pavarur) dhe Baton Dushi (Nisma).

Munguan: Migjen Shala (PDK) dhe Yll Bogaj (AAK).

Të pranishëm ishin edhe: Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, Muhedin Nushi, nënkryetar i Komunës, Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Fatime Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, Bujar Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Valbona Osmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit, Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Shkumbin Gashi, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Vasilika Zotaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Adonis Tahiri, drejtor i drejtorisë së Inspektionit, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit.

Para se të fillonin me diskutimet për rendin e ditës, Shpend Ahmeti, kryetar, propozoi që në rend të ditës të bëhen disa ndryshime, të shtohen dy pika: 1. Propozimvendimi për rishikimin e buxhetit për vitin 2020 (që sipas rekomandimeve të Ministrisë së

Faqe 1 nga 11

Financave, ky rishikim mund të përfshijë vetëm shpenzimet si pasojë e Covid-19, asgjë tjetër nuk guxojmë të lëvizim) dhe 2. Informatë mbi gjendjen shëndetësore në komunën e Prishtinës.

Agim Gashi pyeti se si është e mundur të dënohen komunat kaq shumë me një vendim të paanalizuar mirë, sepse ka disa momente, ku në rrethana të caktuara komunat nuk mund të realizojnë atë që e kanë planifikuar, e aq më pak në këtë vit, ku 4 muaj asnjë cent nuk kanë pasur mundësi ligjore ta shpenzojnë. Do të ishte mirë që të bëhet njëfarë presioni pozitiv në Qeveri, që ata së paku t'i lejojnë komunat për realizimin e projekteve elementare.

Egzon Azemi u shpreh kundër propozimit për rishikimin e buxhetit, duke thënë se kryetari është dashtë që paraprakisht me na njoftuar dhe me na e dërguar materialin, e mos me ardhur këtu me ngritur dorën dhe mos me ditur çka po votojmë!

Po ashtu, tha se nuk pajtohem që pika e dytë e rendit të ditës "Propozimvendimi për aprovimin e pakos ekonomike për mjetet shtesë", të bartet në pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës, pasi që në çdo fund të seancës nuk është numri i njëjtë i asamblistëve dhe nuk merren shumë seriozisht diskutimet të cilat bëhen.

Lidhur me vërejtjet e ngritura nga parafolësit, Shpend Ahmeti, kryetar, dha sqarime të nevojshme.

Halim Halimi propozoi që pika e rendit të ditës "Propozimvendimi për aprovimin e pakos ekonomike për mjete shtesë me rastin e Covid-19", të shtyhet për diskutim për nesër, pra të jetë një mbledhje e jashtëzakonshme, pasi që sot për këtë material jemi të papërgatitur, dhe nuk dijmë se çka votojmë.

Naim Hoxha shprehu mendimin se këto propozime duhet të analizohen, e që më pas të diskutohen.

Leonora Shabani - Bajraktari tha se ne, si LVV, kërkojmë që të shtyhet kjo mbledhje. Sipas anës ligjore, në qershor gjithmonë duhet të jenë të gatshme rishikimet buxhetore dhe komuna është dashtë ta ketë të gatshëm këtë rishikim.

Rifat Deri tha se nuk pajtohem që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhes, andaj kërkoj nga të pranishmit që kjo pikë, e cila ka të bëjë me pakon ekonomike, të aprovohet.

Hafiz Krasniqi sa i përket pikës për miratimin e buxhetit, shprehu mendimin se nëse Qeveria është e përgatitur dhe na ofron të dhëna të mjaftueshme kur te vij në shqyrtim kjo pikë e rendit të ditës, ne në parim duhet ta votojmë të gjithë, në mënyrë që t'i hapim rrugë Komunës së bashku me Qeverinë.

Sami Boroci theksoi se ne mund të procedojmë me të gjitha pikat tjera dhe këtë propozim për rishikim të buxhetit me lënë pas pauzës, kur kryetari të kthehet nga takimi, pastaj ne ta analizojmë, mbase e ka afatin ligjor për me u dorëzuar në Ministrinë e Financave.

Nol Nushi u shpreh se nga arsyetimi që e dha kryetari për rishikim, po shihet se ky rishikim do të bëhet vetëm për 500.000 euro, të cilat i kanë marr për paga. Kisha kërkuar që të vazhdohet me procedimin e të gjithave pikave të rendit të ditës, dhe kur të na sillen informatat e kësaj pike, me e shikuar dhe me vendosur të gjithë bashkërisht.

Leutrim Retkoceri tha se duke pasur parasysh situatën, kërkoj nga të pranishmit që të jenë më të përgjegjshëm karshi shumë çështjeve dhe të jemi korrekt për shkak të situatës.

Prishtina po ballafaqohet ende rënd, e kemi situatën reale, dhe çka kemi me bërë nëse rastet kanë me u rrit me Covid-19, pra jeta e qytetareve është më e rëndësishme sesa kjo pikë.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e dhëna nga Shpend Ahmeti, kryetar, që këto pika të hyjnë në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për dhe me 7 abstenime, u miratuan propozimet që të hyjnë në rend të ditës për diskutim: "Propozimvendimi për rishikimin e buxhetit për vitin 2020" dhe "Informata mbi gjendjen shëndetësore në komunën e Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për dhe 7 abstenime, u miratua ky

Rendi i ditës:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së dytë, mbledhjes urgjente dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Informatë mbi gjendjen shëndetësore në komunën e Prishtinës;
3. Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën janar-mars 2020 (TM 1);
4. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi Fetahut;
5. Informatë nga Drejtoria e Arsimit mbi gjendjen e arsimit gjatë periudhës së pandemisë Covid - 19;
6. Informatë mbi organizimin e procesit të ndarjes së bursave për studentët e komunës së Prishtinës, për vitin akademik 2019-2020;
7. Raporti vjetor i NPL "Stacioni i Autobusëve", SHA, Prishtinë, për vitin 2019;
8. Diskutim për raportin vjetor të punës së Komitetit për Komunitete, për vitin 2019;
9. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
10. Propozimvendimi për rishikimin e buxhetit për vitin 2020;
11. Propozimvendimi për aprovimin e pakos ekonomike për mjete shtesë me rastin e Covid- 19;
12. Pyetje dhe përgjigje;
13. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së dytë, mbledhjes urgjente dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për, u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjes së dytë, mbledhjes urgjente dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë

Informatë mbi gjendjen shëndetësore në komunën e Prishtinës

Lidhur me gjendjen shëndetësore në komunën e Prishtinës, Shpend Ahmeti, kryetar, i njoftoi të pranishmit, duke thënë se që nga e hëna, më 8.06.2020, janë lehtësuar masat, nuk kemi më masa prej orës 21:00 deri në mëngjes, përveç aeroportit tubimeve të mëdha që kanë të bëjnë me ndeshje sportive, përndryshe të gjitha të tjerat janë të hapura.

Kemi pasur një takim me Asociacionin e komunave me Ministrin e Shëndetësisë dhe me përfaqësues të stafit mjekësor, ku kemi diskutuar për situatën aktuale, për shkak se kemi pasur një ngritje të numrave të të infektuarve. Tani ne duhet të mendojmë se a do të kemi mundësi ta kemi gjendjen në kontroll.

Në Prishtinë deri më sot i kemi pasur 113 raste me Covid -19, me dy fatalitete, që kanë qenë me sëmundje shoqëruese, dhe i kemi 73 të shëruar.

Tashmë është e çartë që planet kryesore që ndikojnë në mos përhapjen e virusit, janë pastrimi i duarve, maska dhe distanca 2 metra, pra është mbrojtja më e mirë që mund ta kemi.

Agim Gashi tha se natyrisht që preventiva ndihmon në këtë situatë pandemie, por kisha kërkuar që pronarët e barnatoreve të mos abuzojnë me çmime, pasi që çmimi për këto mjete mbrojtëse siç janë njëra prej tyre dorezat, dallon shumë prej një barnatore në tjetrën. Andaj kërkoj që të jetë një treg stabil, që çmimet të jenë sa më të arsyeshme.

Hafiz Krasniqi u shpreh kundër marrjes së ndonjë vendimi për dënimin e qytetarëve që nuk i rrespektojnë masat mbrojtëse, dhe lidhur me këtë bëri thirrje te kryetari dhe te çdo kompetentë tjetër, me kërkuar prej qytetarëve që ata të jenë respektues të vendimeve të Qeverisë. Nëse duam ta marrim këtë vendim, së pari duhet të sigurohen mjetet mbrojtëse për qytetarët, pastaj ata me i respektuar këto vendime.

Sami Boroci bëri vërejtje për disa lokale, duke thënë se në shumicën e lokaleve kam vërejtur një normalitet, e që në fakt nuk është dashtë të jetë kështu. Pronarët dhe klientët duhet të jenë më të vetëdijesuar për mbajtjen e distancës, e jo të afrohen në përqafim dhe shtërngim duarsh. Besoj që ndoshta ishte dashur me ju tërhequr vërejtjen, nëse ka mundësi, kryetarit dhe neve si Kuvend.

Arbër Vokrri tha se stafi mjekësor nuk po trajtohet ashtu si duhet me pajisjet mbrojtëse. Po na sillen doreza dhe maska, të cilat aspak nuk janë adekuate, andaj kërkoj që kur të bëhen furnizimet me mjetet mbrojtëse në shëndetësi, për herët tjera me pasur parasysh që ato mjete të jenë më të përshtatshme për përdorim.

Naime Osmani tha se masat mbrojtëse në disa raste nuk po respektohen, si p.sh. disa linja të trafikut urban, ku ceku se në autobus udhëtarët nuk mbajnë maska e as nuk i përmbahen distancës. Lidhur me këtë, ajo kërkoj që për fshatin Tenezhdoll të lëshohet një linjë e autobusit, që qarkullimi i udhëtarëve të jet më i lehtë dhe që të mbahet distanca.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, Shpend Ahmeti, kryetar, dha sqarime të nevojshme.

Pika e tretë

Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën janar-mars 2020, TM 1.

Halim Halimi theksoi se Komuna ka grumbulluar të hyra dhe është e përafërt me vitin e kaluar. Mund të themi se jemi të kënaqur me këto të hyra, për shkak të pandemisë, por në muajt në vijim duhet të punojmë shumë me grumbullimin e të hyrave për ta realizuar buxhetin e planifikuar. Kur flasim për shpenzimet, e dimë se këto shpenzime kanë qenë të lidhura direkt me miratimin e buxhetit në Parlamentin e Kosovës, por sa i përket shpenzimeve kapitale, kryesisht në investimeve kapitale, këto shpenzime në tremujorin e parë të këtij viti kanë një rënie krahasuar me vitin paraprak, por me një arsytim që për shkak të pandemisë nuk kanë mundur me u realizuar. Mbetet që për muajt në vijim këto shpenzime kapitale të kryhen.

Hafiz Krasniqi fillimisht ceku se Drejtoria e Financave e meriton një vlerësim real për përgatitjen e këtij raporti, në kompaktësi me Ligjin për financa publike, si dhe në kompaktësi me skemën e kërkuar nga Ministria e Financave, dhe është për t'u vlerësuar. Sa i përket arsytimit se mungesa e realizimit të të hyrave dhe shpenzimet është si pasojë e pandemisë, mendoj se kjo nuk qëndron, sepse pandemia ka shpërthyer në Kosovë pas 15 marsit 2020. Në këtë raport shihet se kemi ngecje të taksat për transaksione infra-rrugore, të hyra nga inspeksioni, taksa për shfrytëzimin e hapësirave publike etj., por mendoj se në disa fusha, si p.sh. të tatimi në pronën e paluajtshme, ka pasur të hyra të realizuara. Po ashtu, janë të paraqitura edhe detyrimet kontigjente, kompensim dëmi për shkak të shpërndarjes së kontratës, kompensim dëmi për mos realizim të kontratës. Për të gjitha këto mos realizime, kërkoj të dijë se a është ndëshkuar dikush për këtë neglizhencë administrative.

Shefqet Osmani tha se sipas të dhënave që na jepen në këtë raport, vërehet se është bërë një gabim të pasqyra e të hyrave, ku thuhet se janë për vitin 2019, e faktikisht ky raport është për vitin 2020. Mendoj se ky gabim mund të përmirësohet. Në këtë raport na paraqiten edhe shumë shpenzime nga dënimet gjyqësore, e që shuma prej 270.000 euro nga detyrimet kontigjente janë tejet shqetësuese.

Fiknete Bejta tha se vonesa e miratimit të buxhetit në Kuvendin e Kosovës ka pezulluar planifikimet dhe krijimin për zbatimin e projekteve kapitale, andaj edhe të shuma e realizimit të shpenzimeve ka ndikuar vonesa e miratimit të buxhetit, jo pandemia.

Vërehet një start i mirë të inkasimi i të hyrave, vetëm me një 0.72% më pak të hyra që kemi krahasuar me vitin paraprak. Po ashtu, edhe performanca buxhetore edhe përkundër vonesës së miratimit të buxhetit, është vetëm 0.2% më pak se periudha e njëjtë e vitit paraprak. Rritja vërehet edhe tek kategoritë e tjera buxhetore, edhe ngecja vërehet vetëm tek shpenzimet kapitale, që është më pak se 14%, që është një vlerë shumë e kënaqshme. Mendoj se ky raport është shumë përmbajtësor dhe i paraprin të dhënave të sakta. Sa i përket raportit të kontingjenteve, ato gjithmonë do të ekzistojnë.

Naim Hoxha propozoi që Kuvendi ta formojë një komision për hetimin e çështjeve kontigjente.

Për këtë pikë diskutuan edhe Agim Gashi, Arbenita Murseli dhe Mirsad Vitia.

Lidhur me vërejtje dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, Valbona Makolli, drejtoreshë, dha sqarime të nevojshme.

Kryesuesi konstatoi se prezent në mbledhje janë 28 anëtarë të Kuvendit, më 18 vota për, 3 kundër dhe 2 abstenime, u miratua Raportit financiar për periudhën janar-mars 2020, TM1.

Pika e katërt

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi Fetahut.

Kryesuesi konstatoi se prezent në mbledhje janë 28 anëtarë të Kuvendit, më 18 vota për, 3 kundër dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi Fetahut.

Pika e pestë dhe e gjashtë

Informatë nga Drejtoria e Arsimit mbi gjendjen e arsimit gjatë periudhës së pandemisë Covid -19 dhe Informatë mbi organizimin e procesit të ndarjes së bursave për studentët e komunës së Prishtinës, për vitin akademik 2019-2020.

Lidhur me informatën e Drejtorisë së Arsimit mbi gjendjen në arsim gjatë periudhës së pandemisë Covid -19, dhe Informatën mbi organizimin e procesit të ndarjes së bursave për studentët e komunës së Prishtinës, për vitin akademik 2019-2020, në pika të shkurtëra të pranishmit i informoi Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit.

Për këto pika diskutuan edhe: Agim Gashi, Vala Peshku, Leonora Shabani- Bajraktari, Sami Boroci dhe Adrian Berisha, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se u përkrahën Informata nga Drejtoria e Arsimit mbi gjendjen në arsim gjatë periudhës së pandemisë Covid -19 dhe Informata mbi organizimin e procesit të ndarjes së bursave për studentët e komunës së Prishtinës, për vitin akademik 2019-2020.

Pika e shtatë

Raporti vjetor i NPL “ Stacioni i Autobusëve”, SHA, Prishtinë, për vitin 2019.

Përkitazi me Raportin vjetor të NPL “ Stacioni i Autobusëve”, në pika të shkurtëra të pranishmit i informoi Rifat Deri, në cilësinë e anëtarit të Komisionit komunal të aksionarëve, i cili tha se ndryshimet e bëra në menaxhmentin e NPL “Stacioni i Autobusëve”, SHA, Prishtinë, në fund të vitit 2018 dhe në fillim të vitit 2019, gjegjësisht ndërrimi i Bordit të drejtorëve dhe përzgjedhja e kryeshefit ekzekutiv, rezultuan me krijimin e një ambienti shumë më të mirë të të bërit biznes, me kushte shumë më të favorshme pune për të gjithë klientët dhe për vetë punonjësit e ndërmarrjes. Në krahasim me vitin paraprak (2018), vërehet një rritje e të hyrave pothuajse në të gjitha shërbimet e ofruara nga kjo ndërmarrje. Menaxhmenti i ri i kësaj ndërmarrjeje arriti që përzgjedhjen e kandidatëve të duhur për këto poste ta përmbyllë deri në tremujorin e katërt të vitit 2019, nëpërmjet konkurseve të hapura publike dhe procedurave të drejta e transparente.

Mirsad Vitia theksoi se këtë ndërmarrje vërtetë e kemi gjetur me shume probleme, mirëpo falë bashkëpunimit të të gjithëve, do të thotë ka një vullnet për përmasimin e punëve. Si anëtar i Komisionit komunal të aksionarëve, kam një shqetësim në mënyrën se si është bërë përzgjedhja e Bordit të ndërmarrjes, pra ky bord është zgjedhur nga dy aksionarët jo edhe nga unë, është zgjedh nga zotëri Rifat Deri dhe Muhedin Nushi, dhe unë e kam kundërshtuar, sepse ajo përzgjedhje është bërë pa transparencë, pa hapje të konkursit publik, pra është bërë zgjedhja në mënyrë të brendshme.

Po ashtu, vërejtje kam edhe te veprimet që i ka bërë kryeshefit ekzekutiv i ndërmarrjes, i cili gjatë fushatës e ka shfrytëzuar rastin dhe iu ka bërë presion punëtorëve, se cilët kandidat duhen të votohen për deputetë.

Muhedin Nushi, nënkryetar i Komunës dhe anëtar i Komisionit komunal të aksionarëve në këtë ndërmarrje, tha se anëtarët e Bordit nuk janë përzgjedhur, por janë emëruar ligjërisht dhe Komisioni i aksionareve e ka shkarkuar bordin paraprak dhe ka emëruar bordin e ri. Ky bord do të funksionojë më tutje me të njëjtën përbërje, sepse kemi të bëjmë me një bord profesional, një doktor shkence dhe tre magjistra të shkencave.

Halim Halimi tha se aksionarët kanë qenë të obliguar edhe viteve tjera të raportojnë, por nuk e kanë bërë, e po e bëjnë tash! Në këtë raport shihet një kritikë e ashpër e bordit të kaluar, mirëpo ai bord i kaluar është zgjedhur prej kësaj qeverie komunale edhe aksionarët janë zgjedhur prej Kuvendit. Një ndërmarrje me një bord të tillë, mund të konkludojmë se nuk kanë dhënë asnjë rezultat në punën e tyre, andaj edhe menaxhmenti i ri aspak nuk ka qenë përgjigjës në përmbushjen e obligimeve të ndërmarrjes.

Vala Peshku tha se krahasuar me vitet paraprake, mund të konstatojmë se kjo ndërmarrje ka një ngritje të të hyrave, ndërsa sa i përket shpenzimeve, ato kanë një zbritje prej 200.000 euro.

Egzon Azemi fillimisht vërejtje bëri për zgjedhjen e bordit në këtë ndërmarrje, për të cilin tha se quhet “bord i përkohshëm”, por askush nuk jep asnjë afat se deri kur ka me qenë ky bord.

Edhe më parë janë bërë jashtëzakonisht shumë kritika me emërimin e bordeve të përkohshme, mirëpo në emërimin e tyre është përmendur data kur iu përfundon mandati, kështu që është dashtë me dhënë një afat se deri kur përfundon mandati i tij.

Leutrim Retkoceri tha se sa i përket çështjes së aksionarëve dhe të bordit, këto dy organe duhet të reflektojnë pak në formën se si zgjedhën, pra nëse janë konform ligjit janë në rregull. Sa i përket këtij raporti vërehet se shqetësuese janë të hyrat që vazhdojnë me qenë më të ulëta se sa shpenzimet dhe është problem për qëndrueshmërinë e ndërmarrjes, pra duhet të ngritet performanca, sepse një ndërmarrje që mbahet prej buxhetit të komunës nuk i duhet askujt.

Sami Boroci tha se nëse e analizojmë raportin vërehet që ka një tendencën të përmisimit të procesit të punës, kështu që me një funksionim të mirëfillt të këtyre ndërmarrjeve, atëherë pa asnjë dyshim secilit ekzekutiv ka me ju dhënë shumë më lehtë qeverisjen edhe implementimin e shumë politikave që lidhen direkt me ndërmarrje.

Sa i përket të hyrave, në rrethana që jemi besoj që ndërmarrjet publike duhet me i subvencionuar dhe ne si Kuvend duhet ti mbështesim në rastet kur na paraqitet nevoja, por nuk jamë që ato vazhdimisht me i subvencionuar.

Hafiz Krasniqi tha se bordi i aksionarëve së bashku me kryeshefin ekzekutiv janë përgjegjës për përpilimin dhe hartimin e raportit apo planin e biznesit të cilin duhet ta paraqesin mandej në institucione tjera. Nëse vërtetë është zgjedhur bordi në bazë të konkursit me rregulla dhe me ligj është që bordi e zgjedh kryeshefin sekretarin dhe drejtorin e financave, mundem të them që është rasti i parë i cili e zgjedh dike në aspektin e profesionalizmit dhe jo partisë politike.

Kryeshefi ekzekutiv i kësaj ndërmarrje z. Hoti nuk i përket asnjë partie e them me bindje të plotë dhe e di punën e tij dhe angazhimin e tij kështu, unë veç ju uroj fat dhe sukses në atë kompani.

Nol Nushi tha se është për tu falenderuar një raport i tillë dhe besoj që ka me na shërbyer që tash vazhdimisht me pas raporte, pra dhe i presim edhe raportet e ndërmarrjeve të tjera që të na sillen, se shumica prej tyre janë duke pësuar ndryshime radikale pozitive.

Shefki Gashi fillimisht tha se unë në këtë raport nuk vëreja se aksionaret kanë aprovuar planin e biznesit, pra me e ditur se kah janë orientimet e një ndërmarrje. Ajo ndërmarrje më parë ka pasur shumë shërbime që janë kryer aty si autolarjen dhe servisin e autobusave, restorantin etj.

Kjo ndërmarrje duhet domosdo ta zgjeroj planin e biznesit, kështu që unë nuk do ta pranoj as nuk e votoj një raport të ndërmarrjes e cila së paku 20% nuk e ka rritur numrin e punëtorëve brenda vitit.

Fiknete Bejta tha se ky raport ka të ngjarë më shumë me plan biznesi se sa me raport financiar. Ka shumë pak informata financiare me shumë të dhënat financiare që janë të shkoqitura në një zë në kategori buxhetore, se sa të na jepen informacione më të plota.

Si veti pozitive të ky raport vërehet se është racionalizimi i shpenzimeve, d.m.th. ndërmarrja ka arritur të zvogëlojë shpenzimet, mirëpo nuk është një menaxher i mirë nëse nuk arrin të gjej kapacitete tjera për të rritur të hyrat.

Raporti financiar duhet të jet më i kompletuar, me të dhëna më të detajuara edhe në aspektin e numrit të punëtorëve kualifikimeve dhe aspektit të shkallës së nivelit menaxherial.

Drilon Pireva tha se bazuar në Ligjin për ndërmarrjet publike, aksionaret kanë të drejtë me e përzgjedh, me emëruar në fakt bordin.

Për të gjitha ndërmarrjet raportojnë aksionaret dhe pse nuk vijnë aksionaret këtu është për shkak që mos me u përball me gjëra të paqena me shpifje të llojllojshme, kështu që ne duhet me u bërë fillimisht serioz pastaj me kërkuar edhe më shumë prej ndërmarrjeve.

Ndërmarrjet e kanë performacën më të mirë se ndonjëherë që e kanë pasur këtu në Komunën e Prishtinës d.m.th. shumica e ndërmarrjeve sot janë shume efikase, kanë ngritur kursimet, shërbimet etj.

Mimoza Sylejmani falenderoi aksionaret, bordin dhe kryeshefin ekzekutiv të ndërmarrjes për hartimin e këtij raporti.

Lihur me raportin tha se si akcionare në ndërmarrjen "Pallati i Rinisë", ju premtoj se për mbledhjen e radhës së Kuvendit do ta sjellim për shqyrtim edhe raportin e kësaj ndërmarrjeje.

Kryesuesi konstatoi se prezent në mbledhje janë 27 anëtarë të Kuvendit, më 19 vota për, 3 kundër dhe 2 abstenime, u miratua Raporti vjetor i NPL " Stacioni i Autobusëve", SHA, Prishtinë, për vitin 2019.

Pika e tetë

Diskutim për raportin vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Raporti vjetor i punës së Komitetit për Komunitete, për vitin 2019.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se prezent në mbledhje janë 26 anëtarë të Kuvendit, më 17 vota për dhe 6 kundër, u miratua Vendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për rishikimin e buxhetit për vitin 2020.

Lidhur me rishikimin e buxhetit për vitin 2020, në pika të shkurtëra të pranishmit i informoi Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës.

Hafiz Krasniqi propozoi që të hiqen dy pozicionet për dhënin e ndihmave financiare për dy klubet sportive, për klubet e futbollit "Prishtina" dhe "Flamurtari".

Egzin Azemi propozoi që të krijohet një komision mikst, me përbërje të anëtarëve nga të gjitha partitë politike të përfaqësuara në Kuvend, për ndarjen e këtyre subvencioneve.

Për këtë pikë diskutuan edhe Kushtrim Sopa, Sami Boroci, Adrian Berisha, Agim Gashi, Leonora Shabani- Bajraktari dhe Bashkim Beha, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Për këtë pikë diskutuan edhe Kushtrim Sopa, Sami Boroci, Adrian Berisha, Agim Gashi, Leonora Shabani- Bajraktari, dhe Bashkim Beha, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 28 vota për, u miratua Vendimi për rishikimin e buxhetit për vitin 2020.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për aprovimin e pakos ekonomike për mjete shtesë me rastin e Covid- 19.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 27 vota për, u miratua Vendimi për aprovimin e pakos ekonomike për mjete shtesë me rastin e Covid- 19.

Pika e dymbëdhjetë Pyetje dhe përgjigje

Sami Boroci, pyetje për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit

Në pjesën e Veternikut kemi një rritje shumë të madhe të ndërtimit ose të popullimit dhe kjo pjesë është mangët sa i përket institucioneve arsimore edhe shëndetësore.

A do të ndërtohet ndonjë çerdhe publike dhe ndonjë shkollë në këtë pjesë, pasi qëduke pasur parasysh pjesa e veternikut veq është bashkuar edhe me Hajvalinë.

Leonora Shabani Bajraktari, pyetje për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit

Kërkoj të dijë se sa është e vërtetë që rojtarët e çerdheve publike që kanë qenë deri tani punëtor te komunës do ti kalojnë një kompani private, kur e dimë që kompanitë private të sigurimit çfarë kushte ofrojnë për punëtorët.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga parafolësit, sqprime të nevojshme dha Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit.

Kushtrim Sopa, pyetje për: Drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit dhe për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

1. A do të merren masa për lagjen "Dardania" dhe rrugën "Hajdar Dushi" ndaj bllokimit të qytetarëve nga parkimi ilegal ose jo i drejtë, duke i zënë parkingjet e banorëve, si dhe bllokimin e lëvizjes së lirë të banorëve të këtyre zonave. Ndërsa në lagjet "Tophane" dhe "Kodra e Trimave" po vazhdojnë aksionet e dënimeve ndaj banorëve të këtyre zonave, ku shenjëzimi i parkingjeve ende nuk është ekzekutuar, andaj situata po keqkuptohet nga policia dhe banorët, ngase dënimet po shënohen herë në njëërën anë të rrugës e herë në tjetrën anë, duke shkaktuar edhe mosmarrëveshje mes banorëve si pasojë e mos-shenjëzimit të parkingjeve.
2. Rruga "Bekim Fehmiu" nuk ka ndriçim adekuat, e cila shtrihet në lagjen "Lakërishta", andaj kërkohet intervenim në sanimin e ndriçimit të kësaj rruge, e cila gjendet tek udhëkryqi i kësaj lagjeje, ose Rruga e zallit, ngase janë dëmtuar shumë ato ekzistuese.
3. A do të merren masa ndaj qenve endacakë në kryeqytet, ngase kohëve të fundit pothuajse në çdo cep të qytetit është rritur numri i tyre, madje vërehet fluks i tyre.

Për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

1. A ka mundësi me u përfshirë në plan të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave shtrimi i rrugës "Mustafë Kruja", tek Parku i Qytetit, ngase rrugët tjera përreth janë shtruar pothuajse të gjitha? Gjithashtu, në fshatin Marec, në lagjen "Vakovc" është kërkuar shtrimi i rrugës, me distancë diku 1000 metra, qysh në vitin 2016, ndërsa së fundi edhe në këtë muaj është ripërsëritur kërkesa nga banorët e kësaj zone për mirëqenien e tyre;
2. Kur do të nisen unazat e Prishtinës, a ka afat të parashikuar për fillimin e këtyre projekteve?

Për drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit:

1. A parashihet të ndërtohen objekte të banimit kolektiv me plan urbanistik tek parkingu përballë Parlamentit të Kosovës.

Për drejtorin e Drejtorisë së Pronës:

1. A do të kompensohen pronat e marra për projektin e mbulimit të lumit në lagjen "Kalabria", ngase aty ka qytetarë të cilët kanë liruar pronat e tyre për përfundimin e këtij projekti, me ç'rast iu është premtuar se do të kompensohen në forma të ndryshme, si koeficient për ndërtim, si dhe kompensim me tokë diku tjetër?
2. Kur do të përfundojnë pjesët e mbetura të këtij projekti?

Për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm

1. A do të jetësohet Plani i vitit 2012, i quajtur "Medrese Çamëria", projekt ky i cili përfshin lagjen "Hani i Dilit" në Prishtinë, lagje kjo e cila aktualisht e ka koeficientin e ndërtimit 1.2. Për shkak të qorrsokaqeve d.m.th. rrugë tejet të ngushta për gjallërim të kësaj pjese sigurisht do të duhet të vlerësohet rritja e koeficientit të ndërtimit, si tek Xhamia e Llapit, me ç'rast ka shkuar diku tek 3.0 - 4.0, pra me mirëkuptim me shqyrtuar mundësinë e përfshirjes së këtij projekti në Hartën Zonale.

Mbledhja përfundoi në orën 17:00.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Agim Kuleta

